



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:171784

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05842947

KPPP.nr. 126/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit CargoBox Logistics DOOEL me VAT MK4023010504540 dhe seli në Maqedoni e Veriut, Tetovë, rr. "145/8", kundër debitorit MAK Transport Sh.P.K., me numër unik identifikues 811160291 dhe seli në Graçanicë, Preoc, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naim Spahiu, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme e datës 04.08.2022, për shkak të humbjes së afatit për paraqitje të prapësimit si dhe prapësimit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 172/22, i lejuar me datë 30.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. LEJOHET kthimi në gjendjen e mëparshme i parashtruar nga debitori MAK Transport Sh.P.K., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 172/22, i lejuar me datë 30.03.2022 nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj.
- II. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit MAK Transport Sh.P.K., ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr. 172/22, i lejuar me datë 30.03.2022 nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, ndërsa procedura në këtë çështje përmbartimore PËRFUNDOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit CargoBox Logistics DOOEL, mbi bazën e dokumenteve të besueshëm, Faturës nr. 490/2017 e datës 22.12.2017, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 172/22, të datës 30.03.2022, me të cilin është urdhëruar debitori MAK Transport Sh.P.K., që kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 1,740.00, me kamatë ligjore

prej 8 %, duke filluar nga data e kalimit të afatit për pagesë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 04.08.2022, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, ndër të tjerash ka theksuar se asnjëherë nuk e ka pranuar urdhrin përmbarim dhe për një gjë të tillë është njoftuar nga zyrtarët e bankës pasi që debitorit i janë bllokuar llogaritë bankare. Pasi që zyra përmbarimore nuk ka prova që urdhri përmbarimor është pranuar personalisht nga debitori dhe i njëjti është privuar nga e drejta e ushtrimit të prapësimit, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe t'i lejohet që brenda afatit ligjor të ushtrojë prapësimin.

Ndërsa, me datë 04.08.2022 debitori ka paraqitur edhe mjetin juridik, prapësimin me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, me arsyetim se kërkesa e kreditorit është parashkruar sipas nenit 355, par. 1 të LPP-së, ku kërkesat reciproke nga kontratat komerciale parashkruhen për tri vite, andaj që nga data 22.12.2017 kur është lëshuar fatura, e deri në datën kur është parashtruar propozimi për përmbarim, kanë kaluar mbi 4 vite. Ka shtuar se nuk ka asnjë provë se fatura i është dorëzuar debitorit, se e njëjta është pranuar në ndonjë formë dhe si e tillë nuk është as e nënshkruar apo vulosur nga ana e debitorit, e poashtu është në gjuhë të huaj dhe nuk është përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitës ligjore të nenit 68.2 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se kërkesa e debitorit është e bazuar, andaj të njëjtën e pranoi si të tillë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata fillimisht shqyrtoi afatshmërinë e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 130.2 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkakun e mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”*, vlerësoi se në rastin konkret debitori ka rënë në dijeni se ndaj tij është duke u

zhvilluar procedurë përbarimore nga momenti i bllokimit të llogarive, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur brenda afatit ligjor.

Nisur nga kjo gjendje, bazuar në dispozitën e nenit 68.2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përbarueshëm për përbarimin me dhunë”*, dhe nenet 17 dhe 18 të LPP-së, lidhur me nenin 129.1 të LPK-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që vlerësoi se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ekzistimi i të cilave i ka pamundësuar debitorit që të paraqes mjetin juridik të prapësimit me kohë.

Në këtë drejtim, gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit dhe gjeti se fatura nr. 490/2017 është lëshuar me datë 22.12.2017 dhe është bërë e arritshme për pagesë pas 10 (dhjetë) ditëve nga data e lëshimit, e në anën tjetër propozimi për përbarim në raport me faturën nga ana e kreditorit është paraqitur me datë 29.03.2022, mbi tre (3) vite nga arritja e borxhit për pagesë. Kësisoj, gjykata erdhi në përfundim se borxhi i cili buron nga fatura nr. 490/2017 është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: *“...prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, përkatësisht fatura mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbarrim e mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbarrimor është përfshi në parashkrim, dhe si e tillë nuk mund t'i nënshtrohet përmbarrimit, rrjedhimisht edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Meqenëse gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarrimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, vendosi që procedura përmbarrimore në këtë çështje të përfundohet.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 130.2, nenin 129.1 të LPK-së, lidhur me nenin 68.2, nenin 64.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, si dhe nenin 13.1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 126/24, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.